



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.84

2005

10 nëntor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9427 datë 13.10.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për bashkëpunimin policor”..... 2735
Vendim i KM nr.671, datë 26.10.2005	Për një shtesë në vendimin nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”..... 2742
Vendim i KM nr.672, datë 26.10.2005	Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit..... 2744
Vendim i KM nr.673, datë 26.10.2005	Për shfuqizimin e vendimin nr.244, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot dhe të skemës së furnizimit me karburant pa akcizë, për përcaktimin e sasive të karburantit, që do të përdoren për mekanikën bujqësore në tri zona të vendit dhe serrat me ngrohje”, të ndryshuar..... 2751

L I G J
Nr.9427, datë 13.10.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për bashkëpunimin policor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4678, datë 1.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË BELGJIKËS PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës, të quajtura më poshtë “Palë Kontraktuese”;

duke u bazuar në angazhimin për të zhvilluar marrëdhënie miqësie dhe bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve dhe në veçanti duke u bazuar në vullnetin e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin policor midis tyre;

duke u bazuar në dëshirën për ta forcuar këtë bashkëpunim policor në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të marra nga të dy shtetet në fushën e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, konkretisht në kuadrin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, si dhe në kuadrin e Konventës nr.108 të Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për mbrojtjen e personave ndaj trajtimit të automatizuar të të dhënave me karakter personal;

duke marrë parasysh se kriminaliteti i organizuar ndërkombëtar përfaqëson një kërcënim të rëndë për zhvillimin social-ekonomik të shteteve kontraktuese dhe se zhvillimet më të fundit të krimit të organizuar ndërkombëtar vënë në rrezik funksionimin e tyre institucional;

duke marrë parasysh se lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe goditja e hyrje-daljeve të paligjshme në territorin përkatës të shteteve dhe ajo e lëvizjeve migratore të paligjshme, si dhe shkatërrimi i rrjeteve të organizuara që marrin pjesë në këto akte të paligjshme, janë një shqetësim për qeveritë dhe parlamentet e dy shteteve tona;

duke marrë parasysh se prodhimi dhe tregtia e paligjshme e drogave dhe e substancave psikotrope përbëjnë një rrezik për shëndetin dhe sigurinë e shtetasve;

duke marrë parasysh se nuk mjafton vetëm harmonizimi i legjislacioneve të përshtatshme për të luftuar me efikasitet të mjaftueshëm dukurinë e lëvizjeve migratore klandestine;

duke marrë parasysh se nevoja e bashkëpunimit policor ndërkombëtar efikas në fushën e krimit të organizuar dhe lëvizjeve migratore të paligjshme konkretisht nëpërmjet shkëmbimit dhe trajtimit të informacioneve, është e domosdoshme për të luftuar dhe për të parandaluar këtë veprimtari kriminale dhe të kundërligjshme;

duke marrë parasysh se përmbushja e kësaj nevoje kërkon një seri masash të duhura dhe një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Palëve Kontraktuese,
kanë vendosur ta përfundojnë këtë Marrëveshje.

Përkufizime

Neni 1

Në këtë Marrëveshje kuptohet me:

- Trafik ndërkombëtar të qenieve njerëzore, çdo akt i qëllimshëm që ka të bëjë me:

a) lehtësimin e hyrjes në territorin e secilës nga Palët Kontraktuese, atë të transitimit, qëndrimit ose daljes nga ky territor, nëse për këtë qëllim është përdorur detyrimi, më konkretisht dhuna ose kërcënimet, ose nëse është përdorur mashtrimi, shpërdorimi i detyrës ose forma të tjera presioni në atë masë që personi nuk ka rrugëdalje tjetër reale dhe të pranueshme, përveçse t'u nënshtrohet këtyre presioneve;

b) shfrytëzimin me çfarëdo lloji mënyre qoftë të një personi, duke e ditur se ky person ka hyrë, transiton ose qëndron në territorin e secilit shtet të Palëve Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje, në kushtet e parashikuara në pikën "a".

- Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: shkeljet e parashikuara nga neni 34 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve e 20 nëntorit 1989, duke përfshirë këtu edhe prodhimin, shitjen, shpërndarjen si dhe forma të tjera trafiku të materialeve me karakter pornografik ku implikohen fëmijë, si dhe mbajtjen, qoftë edhe për përdorim personal, të këtyre llojeve materialeve.

- Asistencë teknike: ndihma e dhënë, në fushën logjistike, shërbimeve të policisë dhe të migrimit.

- Kriminalitet që ka të bëjë me lëndët bërthamore dhe radioaktive: shkeljet që parashikohen në paragrafin 7 të nenit 1 të Konventës së 3 marsit 1980 për mbrojtjen fizike të lëndëve bërthamore, të nënshkruar në Vjenë dhe Nju Jork më 3 mars 1980.

- Pastrim parash: shkeljet që parashikohen nga paragrafi 1 deri në paragrafin 3 të nenit 6 të Konventës së Këshillit të Europës për pastrimin, zbulimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga krimi, nënshkruar në Strasburg më 8 nëntor 1990.

- Kriminaliteti i organizuar: çdo shkelje e parashikuar në nenin 2 të Konventës së 12 dhjetorit të vitit 2000 të Kombeve të Bashkuara që ka të bëjë me kriminalitetin e organizuar transnacional.

- Trajtimi i të dhënave me karakter personal: me të dhëna me karakter personal duhet kuptuar çdo informacion për një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (personi në fjalë); konsiderohet si i identifikueshëm një person i cili mund të identifikohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, pikërisht duke iu referuar një numri identifikimi ose një ose disa elementeve specifike, karakteristikë e identitetit të tij fizik, fiziologjik, psikik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror.

Me trajtim të të dhënave me karakter personal duhet kuptuar çdo operacion ose bashkësi operacionesh të kryera me apo pa ndihmën e proceseve të automatizuara dhe që aplikohen për të dhëna me karakter personal, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose modifikimi, nxjerrja, analiza, përdorimi, komunikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose çdo lloj forme vënie në dispozicion, krahasimi ose lidhja në rrjet, si dhe arkivimi, fshirja dhe asgjësimi i këtyre të dhënave.

- Drogë: çdo substancë, pavarësisht nga origjina e saj natyrore apo sintetike, që figuron në tabelën I ose në tabelën II të Konventës unike për drogat, bërë në Nju Jork më 30 mars 1961.

- Substancë psikotrope: çdo substancë, pavarësisht nga origjina e saj natyrore ose sintetike, ose çdo produkt natyror të tabelave I, II, III ose IV të Konventës për substancat psikotrope të 21 shkurtit 1971.

- Trafik të paligjshëm të drogave dhe të substancave psikotrope: kultivimi, prodhimi ose

trafikun e drogave ose i substancave psikotrope që u kundërvihen qëllimeve të Konventës së 31 marsit 1961 për drogat, Konventës së 21 shkurtit 1971 për substancat psikotrope ose Konventës së Kombeve të Bashkuara të 20 dhjetorit 1988 për trafikun e paligjshëm të drogave dhe të substancave psikotrope.

- Kërkesë urgjente: një kërkesë cilësohet urgjente në rastet kur paraqitja e saj nëpërmjet procedurës administrative formale pranë organeve qendrore rrezikon të pengojë ose të kompromentojë aktin e parandalimit ose të kërimit.

Fushat e bashkëpunimit

Neni 2

1. Secila Palë angazhohet për t'i ofruar Palës tjetër, në bazë të rregullave dhe kritereve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, bashkëpunimin më të gjerë që ka të bëjë me lëmin policor.

2. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për parandalimin, goditjen dhe ndjekjen e akteve të rënda që lidhen me krimin e organizuar dhe në veçanti për:

- aktet kundër jetës, shëndetit dhe paprekshmërisë fizike të personit;
- aktet që lidhen me prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;
- imigracionin e paligjshëm dhe trafikun e qenieve njerëzore;
- organizimin dhe shfrytëzimin e prostitucionit, trafikun e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve;
- kërkimin dhe marrjen e parave nëpërmjet dhunës dhe kërcënimit;
- vjedhjen, trafikun dhe tregtimin e paligjshëm të armëve, municioneve, eksplozivave, lëndëve radioaktive, lëndëve bërthamore dhe lëndëve të tjera të rrezikshme;
- falsifikimet (prodhimin, falsifikimin, transformimin ose shpërndarjen) e dokumenteve të identitetit të mjeteve të pagesës, çeqeve dhe letrave të tjera me vlerë;
- kriminalitetin në fushën e shkëmbimeve tregtare e financiare;
- aktet kundër pasurisë, midis të tjerash, vjedhja dhe trafiku i veprave të artit dhe atyre me vlerë historike (vjedhje me dhunë dhe vjedhje me thyerje);
- vjedhjet me ose pa dhunë, tregtimin e paligjshëm dhe trafikun e mjeteve motorike, si dhe falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara të automjeteve;
- pastrimin e parave.

3. Aktet e rënda që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe që nuk janë përmendur në nenin 1 mbeten për t'u vlerësuar nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shteteve të tyre.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të përfshijë edhe:

- kërkimin e personave të zhdukur, si dhe ndihmën për identifikimin e kufomave të paidentifikuara;
- kërkimin në territorin e secilës Palë Kontraktuese të sendeve të vjedhura, të zhdukura, si dhe të marra në mënyrë të paligjshme ose të humbura në territorin e shtetit tjetër.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në fushat e specifikuara në nenet 2 dhe 3 të sipërpërmendura nëpërmjet:

- shkëmbimit të informacioneve që u përkasin fushave në kompetencë të autoriteteve të policisë dhe të migrimit;
- shkëmbimit të pajisjeve;
- asistencës teknike dhe shkencore, ekspertimeve dhe dhënies së materialit teknik të specializuar;

- shkëmbimit të përvojave;
 - bashkëpunimit në fushën e formimit profesional;
 - ndihmës në përgatitjen e ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë gjyqësore;
- sipas dispozitave që vijojnë më poshtë.

Shkëmbimi i informacioneve

Neni 5

Palët Kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës asistencë dhe do të sigurojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe të përhershëm. Ato do të kryejnë gjithashtu edhe shkëmbim të të gjitha informacioneve të nevojshme dhe të rëndësishme.

Ky bashkëpunim mund të marrë formën e një kontakti të përhershëm nëpërmjet oficerëve ndërlidhës që do të caktohen.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese angazhohen se shërbimet e tyre policore do t'i japin njëra-tjetrës, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe në kuadrin e kompetencave të tyre, asistencë për parandalimin dhe ndjekjen e akteve të dënueshme me ligj për aq sa e drejta e brendshme e Palës Kontraktuese të kërkuar nuk ua nënshtron kërkesën ose ekzekutimin e saj autoriteteve gjyqësore.

2. Në raste të veçanta, secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe pa ia kërkuar këtë Pala tjetër, mund t'i komunikojë Palës tjetër Kontraktuese informacione që mund të jenë të rëndësishme për këtë të fundit, me qëllim që ta ndihmojë për parandalimin dhe goditjen e akteve që parashikohen në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje ose për të parandaluar kërcënime për rendin dhe sigurinë publike të saj.

Neni 7

Çdo informacion i dhënë nga Pala Kontraktuese e kërkuar mund të përdoret nga Pala Kontraktuese kërkuese për të paraqitur prova të akteve të inkriminuara vetëm pas një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë gjyqësore në përputhje me dispozitat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi.

Neni 8

1. Kërkesat për asistencë dhe përgjigjet ndaj tyre duhet të shkëmbehen ndërmjet organeve qendrore që janë të ngarkuara, nga secila Palë Kontraktuese, për bashkëpunimin policor ndërkombëtar dhe imigrimin.

Në rast se kërkesa nuk mund të paraqitet për arsye kohe nëpërmjet kësaj rruge, për raste të veçanta dhe vetëm në raste urgjente, ajo mund t'i paraqitet drejtpërsëdrejti nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe këto të fundit mund t'u përgjigjen atyre drejtpërsëdrejti. Në këto raste të veçanta, autoriteti kërkues duhet të njoftojë në afatet më të mira për këtë kërkesë të drejtpërdrejtë dhe duke shpjeguar motivet e urgjencës së saj organit qendror të ngarkuar për bashkëpunim policor ndërkombëtar të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Përcaktimi i organeve qendrore të ngarkuara për bashkëpunimin policor ndërkombëtar, si dhe mënyrat e asistencës së ndërsjellë rregullohen sipas vendimeve që do të merren ndërmjet ministrave kompetentë të Palëve Kontraktuese.

Neni 9

Autoriteti kompetent kërkues duhet të garantojë shkallën e sekretit që autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese ka përcaktuar për informacionin. Nivelet e sigurisë janë ato që përdoren nga Interpoli.

Neni 10

1. Palët Kontraktuese mund të vendosin për një kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar oficerë ndërlidhës të tyre pranë Palës tjetër Kontraktuese.

2. Vendosja e oficerëve ndërlidhës për një kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar ka si qëllim zhvillimin dhe përshejtimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve Kontraktuese, konkretisht duke rënë dakord për asistencën:

a) në formën e shkëmbimit të informacioneve me qëllim për të luftuar krimin si në planin parandalues, ashtu dhe në atë goditës;

b) në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore të ndërsjellë në fushën penale;

c) për nevoja të ushtrimit të misioneve të autoriteteve të ngarkuara për mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm dhe atyre të imigracionit;

d) për nevoja të ushtrimit të misioneve të autoriteteve të ngarkuara me parandalimin e kërcënimeve për rendin publik.

3. Oficerët ndërlidhës kanë si mision dhënien e mendimeve dhe të asistencës. Ata nuk janë kompetentë për ekzekutimin autonom të masave policore. Ata japin informacione dhe zbatojnë misionet e tyre sipas udhëzimeve të Palës Kontraktuese të origjinës së tyre, si dhe atyre të Palës Kontraktuese pranë së cilës janë vendosur. Ata i raportojnë rregullisht organit qendror të ngarkuar me bashkëpunimin policor ndërkombëtar të Palës Kontraktuese pranë së cilës janë vendosur.

4. Ministrat kompetentë të Palëve Kontraktuese mund të bien dakord që zyrtarët ndërlidhës të njëjës Palë Kontraktuese të vendosur pranë shteteve të treta të përfaqësojnë dhe interesat e Palës tjetër Kontraktuese.

5. Oficeri ndërlidhës mund të atashohet ose të akreditohet pranë një misioni të tretë diplomatik të një shteti të Bashkimit Europian.

Mbrojtja e të dhënave me karakter personal

Neni 11

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, trajtimi i të dhënave me karakter personal i nënshtrohet legjislacionit të brendshëm respektiv të secilës Palë Kontraktuese.

2. Përsa i përket trajtimit të të dhënave me karakter personal në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese angazhohen të realizojnë një nivel mbrojtje të të dhënave me karakter personal që respekton dispozitat e Konventës së Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për mbrojtjen e personave ndaj trajtimit automatik të të dhënave me karakter personal dhe të Rekomandimit R(87) 15 të 17 shtatorit 1987 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, i cili ka për objekt rregullimin e përdorimit të të dhënave me karakter personal në sektorin e policisë.

3. Përsa i përket trajtimit të të dhënave me karakter personal, të transmetuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Të dhënat mund të përdoren nga Pala Kontraktuese që i merr vetëm sipas qëllimeve për të cilat kjo Marrëveshje parashikon transmetimin e tyre. Përdorimi i të dhënave për qëllime të tjera është i mundur vetëm pas autorizimit paraprak të Palës Kontraktuese që i jep ato dhe duke respektuar legjislacionin e Palës Kontraktuese që i merr ato.

b) Të dhënat mund të përdoren vetëm nga autoritetet gjyqësore dhe shërbimet e instancat që kanë detyra ose përmeshin funksione në kuadrin e qëllimeve që synon kjo Marrëveshje, konkretisht ato të parashikuara në nenet 2 dhe 3. Palët do t'i komunikojnë njëra-tjetrës listën e përdoruesve të këtyre të dhënave.

c) Pala kontraktuese që transmeton të dhënat është e detyruar të garantojë se ato janë të sakta dhe të plota. Ajo është e detyruar gjithashtu që të interesohet që këto të dhëna të mos ruhen më shumë sesa është e nevojshme. Nëse ajo konstaton me iniciativën e saj ose pas kërkesës së personit të interesuar se ka transmetuar të dhëna të pasakta ose që nuk duheshin transmetuar, Pala ose Palët Kontraktuese marrëse duhet të informohen sa më shpejt; kjo ose këto të fundit janë të detyruara që të bëjnë korrigjimin ose asgjësimin e të dhënave, ose të njoftojnë se këto të dhëna janë të pasakta ose nuk duhej të ishin transmetuar.

d) Asnjëra nga Palët Kontraktuese nuk mund të përdorë si pretekst faktin që një Palë tjetër

Kontraktuese të ketë transmetuar të dhëna të pasakta, me synim që të shkarkohet nga përgjegjësia që i takon në bazë të së drejtës së saj të brendshme, ndaj personit të dëmtuar.

e) Dhënia dhe marrja e të dhënave me karakter personal duhet të regjistrohen. Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës listën e autoriteteve apo shërbimeve të autorizuar për të kërkuar informacion mbi regjistrimin.

f) Njohja me të dhënat bëhet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës Kontraktuese të cilës personi i interesuar i paraqet kërkesën. Komunikimi i të dhënave personit të interesuar është i mundur vetëm pasi është kërkuar autorizimi i Palës Kontraktuese që i ka transmetuar këto të dhëna.

g) Të dhënat mund të përdoren nga Pala Kontraktuese marrëse vetëm për qëllimet e përcaktuara nga Pala Kontraktuese transmetuese dhe duke respektuar kriteret e përcaktuara nga kjo Palë Kontraktuese;

4. Përveç kësaj, përsa i përket transmetimit, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Të dhënat mund t'u transmetohen vetëm autoriteteve dhe shërbimeve policore dhe të imigrimit; komunikimi i të dhënave instancave të tjera që ndjekin të njëjtat objektiva si këto shërbime e autoritete dhe që veprojnë në të njëjtin kuadër, mund të bëhet vetëm pas autorizimit paraprak të Palës Kontraktuese që i jep ato.

b) Në bazë të një kërke, Pala Kontraktuese marrëse e informon Palën Kontraktuese dhënëse për përdorimin që u ka bërë këtyre të dhënave dhe rezultateve që ka arritur në bazë të tyre.

5. Secila Palë Kontraktuese përcakton një autoritet kontrolli të ngarkuar, duke respektuar të drejtën e saj të brendshme, për të ushtruar në territorin e saj një kontroll të pavarur të trajtimeve të të dhënave me karakter personal të kryera në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe për të verifikuar nëse këto trajtime nuk kanë cenuar të drejtat e personit të interesuar. Këto autoritete kontrolli janë kompetente, gjithashtu për të analizuar vështirësitë e zbatimit dhe të interpretimit të kësaj Marrëveshjeje lidhur me trajtimin e të dhënave me karakter personal. Këto autoritete kontrolli mund të bien dakord midis tyre për të bashkëpunuar në kuadër të misionëve që u njihen nga kjo Marrëveshjeje.

Neni 12

Në rastet kur të dhënat me karakter personal transmetohen nëpërmjet oficerit ndërlidhës të parashikuar në nenin 10, zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, vetëm kur ky zyrtar ndërlidhës ia transmeton këto të dhëna Palës Kontraktuese pranë së cilës është vendosur.

Përfundimi

Neni 13

Secila Palë Kontraktuese refuzon asistencën kur bëhet fjalë për krime politike ose ushtarake, si dhe kur kjo asistencë rezulton në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në territorin e saj. Secila palë mund ta refuzojë asistencën ose ta kushtëzojë atë kur bëhet fjalë për akte antiligjore politike ose ushtarake.

Secila Palë Kontraktuese mund ta refuzojë asistencën ose t'ua nënshtrojë disa kushteve kur bëhet fjalë për krime të lidhura me krimet politike ose ushtarake ose kur realizimi i saj mund të kërcënojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik dhe interesa të tjerë thelbësorë të shtetit.

Forma të tjera të bashkëpunimit

Neni 14

1. Palët Kontraktuese bien dakord për t'i dhënë njëra-tjetrës asistencë në fushën e formimit profesional dhe asistencë teknike për problemet që lidhen me funksionimin e policisë.

2. Palët Kontraktuese bien dakord për të shkëmbyer përvojat e tyre praktike në të gjitha fushat që përfshihen në këtë Marrëveshjeje.

3. Mënyrat e dhënies së asistencës së ndërsjellë rregullohen sipas vendimeve të përbashkëta të ministrave kompetentë të Palëve Kontraktuese.

Grupet e përbashkëta të punës

Neni 15

1. Palët Kontraktuese mund të ngrejë grupe pune, të përhershme ose rast pas rasti, të ngarkuara me analizën e problemeve të përbashkëta, lidhur me goditjen dhe parandalimin e tipologjisë kriminale të parashikuar në nenin 2, si dhe për fushat e bashkëpunimit të parashikuara në nenin 3 dhe në rast nevojë hartojnë propozime që synojnë përmirësimin e aspekteve praktike dhe teknike të bashkëpunimit midis Palëve Kontraktuese.

2. Shpenzimet për realizimin e bashkëpunimit mbulohen nga secila Palë Kontraktuese, përveç rasteve kur përfaqësuesit kompetentë të Palëve Kontraktuese vendosin ndryshe.

3. Ministrat kompetentë të Palëve Kontraktuese krijojnë një grup vlerësimi, i cili çdo tre vjet u paraqet një raport ministrave.

Rregullimi i mosmarrëveshjeve

Neni 16

Çdo mosmarrëveshje e shkaktuar nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nga një komision i përzier konsultativ.

Për të lehtësuar zgjidhjen e problemeve që do të dalin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, ngrihet një komision i përzier konsultativ i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, asaj të Brendshme, të Rendit Publik dhe të Drejtësisë, që do të mbledhet periodikisht dhe me kërkesën e njërit apo tjetrit shtet.

Dispozita të fundit

Neni 17

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen vetëm kur nuk bien ndesh me të drejtën e brendshme.

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të realizohet në përputhje me të drejtën e brendshme të secilës nga Palët Kontraktuese.

Neni 18

Palët Kontraktuese do t'i bëjnë të ditur njëra-tjetrës me shkrim dhe në rrugë diplomatike përmbushjen e formaliteteve kushtetuese të parashikuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë që pason datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim.

Kjo Marrëveshje është përfunduar për një kohëzgjatje të pakufizuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta anulojë atë nëpërmjet një njoftimi me shkrim dërguar në rrugë diplomatike Palës tjetër Kontraktuese. Anulimi hyn në fuqi 6 muaj pas datës së dërgimit të këtij njoftimi.

Neni 19

Secila Palë Kontraktuese mund t'i dërgojë Palës tjetër Kontraktuese çdo propozim që synon të modifikojë këtë Marrëveshje. Palët Kontraktuese vendosin me miratim të përbashkët për modifikime në këtë Marrëveshje.

Duke u bazuar sa më sipër, të nënshkruarit, ligjërisht të autorizuar për këtë akt, kanë vendosur firmat e tyre në fund të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Bruksel, më 22 mars 2005, në dy ekzemplarë origjinalë, secili prej tyre në gjuhët shqip, frëngjisht dhe holandisht, dhe të tre tekstet në secilën gjuhë janë të barasvlefshëm.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministri i Rendit

Për Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës
Ministre e Drejtësisë

Igli Toska

Laurette Onkelinx

Ministri i Brendshëm
Patrik Dewael

VENDIM
Nr.671, datë 26.10.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “C”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, të listës “Lista e personave të shpallur, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”)), të vendimit nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të shtohet shtetasi Abdyl Latif Saleh, i datëlindjes 5 mars 1957, lindur në Bagdat, Irak, i cili mban shtetësi jordanëze, me nr.pasaporte D 366871 dhe shqiptare, dhe ka të dhënat e pasqyruara në pasqyën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



THE NEW CONSOLIDATED LIST OF INDIVIDUALS AND ENTITIES BELONGING TO OR ASSOCIATED WITH THE TALIBAN AND AL-QAIDA ORGANISATION AS ESTABLISHED AND MAINTAINED BY THE 1267 COMMITTEE

C. The list of individuals belonging to or associated with the Al-Qaida organisation

No.	Personal identifiers	Alias	Nationality, Passport no., ID no., on and address	Listed on	Other information
-----	----------------------	-------	---	-----------	-------------------

Nr. 160

<i>Name 1:</i> Abdul	<i>Good quality a.k.a.:</i> a) Abdul Latif	<i>Nationality:</i> a) Jordanian	16 Sept.
<i>Name 2:</i> Latif	A.A. Saleh		2005
<i>Name 3:</i> Saleh		b) Albanian	
<i>Name 4:</i>	b) Abdyl Latif Saleh		
<i>Title:</i> Dr.	c) Dr. Abd al-Latif Saleh	<i>Passport no.:</i> Jordanian Passport: D366 871	
<i>Designation:</i>	d) Abdul Latif A.A. Saleh Abu Hussein	<i>National identification no.:</i>	
<i>DOB:</i> 5 Mar. 1957	e) Abd al-Latif Salih	<i>Address:</i>	
<i>POB:</i> Baghdad, Iraq	f) Abu Amir	Last known residence: United Arab Emirates	
	<i>Low quality a.k.a.:</i>		

VENDIM
Nr.672, datë 26.10.2005

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 24 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË
KONTABILITETIT**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 21 të ligjit nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Statusi, objektivat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit

1. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (në vijim KKK) është një organ profesional, publik, i pavarur i krijuar në mbështetje të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (në vijim ligji për kontabilitetin). KKK ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe aktet e tjera nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

2. Objektivat kryesorë të KKK-së janë:

- a) Përsosja e vazhdueshme e legjislacionit për kontabilitetin;
- b) Përpunimi i sistemit kontabël në përputhje me ligjin për kontabilitetin;
- c) Hartimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit;
- d) Nxitja e përdorimit dhe zbatimit të SKK dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3. Për të përmbushur detyrat e tij, KKK:

- a) i paraqet propozime Ministrit të Financave për përgatitjen ose ndryshimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontabilitetit;
- b) harton SKK, në zbatim të ligjit për kontabilitetin;
- c) harton rregulla të tjera dhe rregullore në fushën e kontabilitetit;
- d) jep shpjegime, interpreton dhe përgjithëson problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël kombëtare, në formën e udhëzimeve kontabël.

e) krijon komisione të specializuara të përhershme ose të përkohshme dhe përfshin ekspertë për zhvillimin e SKK dhe legjislacionit, si dhe për diskutimin e problemeve në fushën e kontabilitetit;

f) rishikon dhe shpreh opinionet e tij mbi projektaktet ligjore dhe nënligjore, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin dhe profesionet;

g) organizon punën për përkthimin e SNRF;

h) jep rekomandime për përgatitjen e specialistëve kontabilistë në shkollat e larta;

i) vendos dhe mban kontakte me organizma botërorë të kontabilitetit (përfshirë Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) të Bashkimit Europian dhe organe të tjera të hartimit të standardeve në vende të tjera) dhe merr pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare që lidhen me kontabilitetin;

j) u krijon mundësi anëtarëve të tij të marrin pjesë në konferenca dhe seminare profesionale në Shqipëri dhe jashtë vendit.

4. Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë aktet nënligjore administrative të detyrueshme për KKK-në për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për kontabilitetin dhe kjo rregullore. KKK është i pavarur në hartimin e sistemit kontabël, të SKK dhe rregullimeve të tjera kontabël.

KAPITULLI 2 PËRBËRJA E KKK-së

Neni 2

Anëtarët e KKK-së

1. KKK përbëhet nga nëntë anëtarë, të cilët zgjidhen, propozohen dhe emërohen në përputhje me nenin 20 të ligjit për kontabilitetin.

2. Anëtarët e KKK-së kanë mandat 6-vjeçar, me përjashtim të anëtarëve të mandatit të parë, të cilët, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 20 të ligjit për kontabilitetin, emërohen për një mandat 4-vjeçar. Ata mund të marrin një mandat të dytë, me propozim të organeve përkatëse, dhe miratimin e Këshillit të Ministrave.

3. Anëtarët e KKK-së angazhohen me kohë jo të plotë pune.

4. Shpërblimet për anëtarët e KKK-së propozohen nga kryetari i KKK-së dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Dorëheqja e një anëtari të KKK-së

1. Kur një anëtar i KKK-së vendos të tërhiqet nga detyra, duhet t'i paraqesë kërkesë me shkrim për dorëheqje organit që e ka propozuar dhe kryetarit të KKK-së, i cili ia përcjell për miratim Ministrisë të Financave.

2. Ministri i Financave i paraqet Këshillit të Ministrave një projektvendim jo më vonë se 30 ditë pas kërkesës me shkrim për dorëheqjen e anëtarit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, në lidhje me largimin e anëtarit të vjetër dhe caktimin e një anëtari të ri. Anëtari i ri propozohet nga i njëjti organ që ka propozuar edhe anëtarin që jep dorëheqjen.

Neni 4

Heqja e mandatit të një anëtari të KKK-së

1. Kryetari i KKK-së njofton menjëherë Ministrin e Financave nëse janë rrethanat e përmendura në paragrafin 8 të nenit 20 të ligjit për kontabilitetin. Ministri i Financave gjykon mbi rrethanat, dhe nëse e çmon të arsyeshme, i paraqet Këshillit të Ministrave propozim për heqjen e mandatit të një anëtari të KKK-së ose njofton kryetarin e KKK-së në rast mospranimi të propozimit për heqjen e mandatit.

2. Një anëtar i KKK-së konsiderohet se nuk përmbush kërkesat e kësaj rregulloreje dhe mund t'i hiqet mandati kur:

a) nuk i pranon ose nuk i përmbush detyrimet në KKK;

b) shkel rëndë kodin e etikës profesionale të miratuar nga KKK (deri sa KKK të miratojë një kod të tillë, do të përdoret si bazë "Kodi i etikës së kontabilistëve profesionistë" i IFAC (Komiteti i

Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve);

c) nuk merr pjesë në të paktën 50% të mbledhjeve gjatë një viti pa arsye.

3. Në rastin e heqjes së mandatit ose kur një anëtar i KKK-së vdes, Ministri i Financave i propozon Këshillit të Ministrave një anëtar të ri, i cili duhet të miratohet në vend të tij jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

KAPITULLI 3 KRYETARI DHE NËNKRYETARI

Neni 5

Kryetari dhe nënkryetari i KKK-së

1. Veprimtaritë e KKK-së kryesohen nga kryetari i KKK-së (në vijim kryetari), që:
 - a) përgatit programin e punës së KKK-së;
 - b) organizon mbledhjet dhe cakton kohën, organizon përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe miraton projektrendin e ditës së mbledhjes;
 - c) drejton mbledhjet e KKK-së;
 - d) nënshkruan/miraton korrespondencën e KKK-së.
2. Në mungesë të kryetarit, detyrat e tij kryhen nga nënkryetari (në vijim nënkryetari).

Neni 6

Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarit

1. Kryetari dhe nënkryetari i KKK-së zgjidhen nga vetë anëtarët e tij. Mandati i tyre është 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Procedura për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit do të fillojë në sesionin e parë të përbërjes së re të KKK-së ose në sesionin e radhës pas caktimit të një anëtarit të ri në vend të kryetarit dhe nënkryetarit.
3. Mbledhja për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit zhvillohet kur krijohet kuorumi prej të paktën 7 (shtatë) anëtarë.
4. Kryetari zgjidhet para nënkryetarit. Anëtarët e KKK-së nuk kanë të drejtë abstenimi. Votimi për kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit është i fshehtë. Për zhvillimin e mbledhjes dhe rezultatet e votimit mbahet procesverbal. Për realizimin e procesit të votimit ngrihet një komision prej 3 (tre) anëtarësh të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të cilët nuk konkurrojnë.
5. Para kryerjes së votimit, anëtarit që propozohet duhet të pranojë kandidimin e tij për postet e mësipërme.
6. Kur konkurrojnë disa kandidatë, një anëtar i KKK-së voton vetëm për një kandidat. Nëse konkurron vetëm një kandidat, anëtarit i KKK-së voton kundër ose pro tij. Kryetar dhe nënkryetar zgjidhet kandidati që fiton të paktën 5 (pesë) vota të anëtarëve të KKK-së.
7. Kur në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk ka fituar numrin e nevojshëm të votave, në votimin e dytë votohet vetëm për dy prej atyre që kanë marrë shumicën e votave. E njëjta procedurë ndiqet edhe për zgjedhjen e nënkryetarit.
8. Në rast se kryetari ose nënkryetari nuk zgjidhen për shkak se asnjë nga kandidatët nuk marrin numrin e nevojshëm të votave ose nuk është arritur minimumi i nevojshëm i votave, zgjedhjet përsëriten në një mbledhje tjetër. Nëse kryetari dhe nënkryetari nuk arrijnë të zgjidhen as në mbledhjen e dytë, mbledhja tjetër zhvillohet brenda 10 ditësh-pune.
9. Kur për arsyet e përmendura në paragrafin e mësipërm kryetari ose nënkryetari nuk arrijnë të zgjidhen në 3 (tre) mbledhje radhazi, atëherë kryetari ose nënkryetari caktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave.

KAPITULLI 4 ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE DHE MARRJA E VENDIMEVE NË KKK

Neni 7
Mbledhja

1. Vendimet e KKK-së merren në mbledhjet e këtij Këshilli.
2. Mbledhjet realizohen në përputhje me problemet dhe nevojat, si rregull çdo muaj, dhe jo më pak se 12 të tilla në vit.

Neni 8
Thirrja e mbledhjes

1. Mbledhjet thirren nga kryetari. Mbledhja e parë pas krijimit të KKK-së thirret nga Ministri i Financave brenda 30 ditëve nga dita e emërimit të anëtarëve të KKK-së.
2. Njoftimi për mbledhje u dërgohet anëtarëve të KKK-së nga kryetari me postë, faks ose postë elektronike të paktën dhjetë ditë-pune para datës së zhvillimit të saj.
3. Njoftimi për mbledhje përcakton kohën, vendin dhe rendin e ditës, si dhe hollësi të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me të. Njoftimit i bashkëlidhen edhe materialet që kanë të bëjnë me çështjet e rendit të ditës.

Neni 9
Rendi i ditës së mbledhjes

1. Të gjithë anëtarët e KKK-së mund të propozojnë çështje të rendit të ditës për sesionin e ardhshëm, të cilat miratohen nga KKK. Në intervalin e kohës midis dy mbledhjeve kryetari ka të drejtën të shtojë çështje shtesë në rendin e ditës pa votimin e anëtarëve të KKK-së.
2. Në mbledhjen e ardhshme përfshihet në rendin e ditës një pikë/çështje për diskutim, e cila në mbledhjen paraardhëse është miratuar me shumicë të thjeshtë votash. Ndonjë pikë/çështje për diskutim që ka qenë e përfshirë në rendin e ditës të mbledhjes së mëparshme, por për shkak të kohës së kufizuar nuk është arritur të trajtohet, kalon automatikisht për diskutim në rendin e ditës të mbledhjes së mëpasshme.

Neni 10
Mbledhja dhe marrja e vendimeve

1. Mbledhjet drejtohen nga kryetari. Në mungesë të tij do të drejtohen nga nënkryetari. Deri në zgjedhjen e kryetarit, ose në rast se si kryetari ashtu edhe nënkryetari mungojnë, mbledhjet drejtohen nga anëtari më i moshuar i KKK-së.
2. Kuorumi i kërkuar për marrjen e vendimeve në mbledhjet e KKK-së është prania e të paktën gjashtë anëtarëve.
3. Çdo anëtar i KKK-së ka të drejtën e një vote. Anëtarët e KKK-së nuk duhet të abstenojnë në votim. Në rast të votave të barabarta, vota e drejtuesit të mbledhjes është përcaktuese.
4. Standardet kombëtare të kontabilitetit dhe produktet e tjera kontabël, që lidhen me plotësimin e objektivave të KKK-së, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 1 të kësaj rregulloreje, miratohen nga të paktën pesë anëtarë të KKK-së. Çështjet e tjera miratohen me një shumicë të thjeshtë votash.
5. Anëtari i KKK-së nuk mund të marrë pjesë në votim, kur ka konflikt interesash, siç përcaktohet në Kodin e Etikës të miratuar nga KKK (deri sa KKK të miratojë kodin e vet do të përdoret Kodi i Etikës i Komitetit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Kur ka konflikt interesash, anëtari njofton drejtuesin e mbledhjes para se çështja përkatëse të diskutohet në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Neni 11
Marrja e një vendimi jashtë mbledhjeve

1. Vendimet e KKK-së të cilat, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 10, kërkojnë një shumicë të thjeshtë votash, mund të merren edhe jashtë mbledhjes. Për marrjen e vendimit në këtë rast, kryetari i KKK-së u përcjell anëtarëve të KKK-së projektvendimin përkatës dhe materialet që lidhen me të dhe cakton një afat të paktën pesë ditë-pune për marrjen e përgjigjeve dhe të reagimeve të anëtarëve.

2. Projektvendimi miratohet kur të paktën pesë anëtarë të KKK-së votojnë në favor të tij. Anëtarët që nuk kthejnë përgjigje brenda afatit të kërkuar do të konsiderohen sikur janë pro vendimit.

3. Rezultatet e votimit pasqyrohen në një procesverbal të posaçëm sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje.

4. Kryetari i KKK-së shpall rezultatet e votimit në mbledhjen e parë pas afatit të caktuar prej tij për marrjen e përgjigjeve.

Neni 12

Mundësia e pjesëmarrjes në mbledhje

Si rregull, mbledhjet e KKK-së janë të mbyllura. Pjesëmarrja e palëve të interesuara ose publikut të gjerë vendoset nga drejtuesi i mbledhjes, me miratimin e shumicës absolute të anëtarëve.

Neni 13

Mbajtja e procesverbaleve të mbledhjeve

1. Për mbledhjet e KKK-së mbahen procesverbale të veçanta.

2. Procesverbalet pasqyrojnë:

a) numrin-radhën e mbledhjes;

b) datën dhe vendin e mbledhjes, kohën e fillimit e të mbylljes;

c) emrin e drejtuesit dhe sekretarit të mbledhjes;

d) emrat e anëtarëve të KKK-së të pranishëm, si dhe emrat e personave të tjerë;

e) rendin e ditës;

f) vendimet e marra dhe rezultatet e votimit;

g) shënime të mendimeve të pakicës, kur kërkohet nga anëtari që është në pakicë;

h) hollësi të tjera që gjykohen të rëndësishme.

3. Mendimi me shkrim i pakicës i anëtarit të KKK-së paraqitet në sekretari i nënshkruar menjëherë pas votimit të vendimit me të cilin lidhet mendimi në fjalë, por jo më vonë se ditën pasardhëse të punës.

4. Procesverbalet e mbledhjes nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari, nga anëtari i KKK-së që ka shprehur mendimin në pakicë. Kryetari mban përgjegjësi për pasqyrimin e saktë dhe të plotë të vendimit të marrë dhe rezultateve të votimit.

5. Procesverbalet origjinale të nënshkruara, njoftimi për mbledhje dhe materialet shoqëruese arkivohen në zyrat e KKK-së.

KAPITULLI 5

KOMISIONET E PËRHERSHME OSE TË PËRKOHSHME

Neni 14

Komisionet e veçanta të përhershme ose të përkohshme

1. Me qëllim që të përmbushë detyrat e tij, KKK mund të ngrejë komisione të posaçme/të specializuara të përhershme ose të përkohshme.

2. Komisionet e posaçme/të specializuara të përhershme ose të përkohshme mund të përfshijnë, përveç anëtarëve të KKK-së, edhe specialistë të tjerë nga fusha të lidhura me kontabilitetin ose të tjerë.

3. Komisionet e posaçme/të specializuara të përhershme ose të përkohshme ngrihen kur vendoset nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të KKK-së.

4. Komisionet e posaçme/të specializuara të përhershme ose të përkohshme ngrihen për të:
 - a) zhvilluar strategji për veprimtarinë e KKK-së në tërësi ose në fusha të caktuara;
 - b) hartuar një SKK të ri ose për të përpunuar një SKK ekzistues;
 - c) hartuar rregulla dhe rregullore të tjera në fushën e kontabilitetit dhe profesionet e kontabilitetit;
 - d) diskutuar problemet dhe propozuar zgjidhje në lidhje me çështje të veçanta të kontabilitetit;
 - f) rishikuar dhe shprehur mendimet e tij për projektligje dhe rregullore të ndryshme, të cilat përmbajnë dispozita të veçanta mbi kontabilitetin dhe profesionet e lidhura me të;
 - g) ndjekur dhe rishikuar procesin e përkthimit të SNRF;
 - h) të tjera lidhur me misionin e KKK.
5. KKK ka të drejtë të kontaktojë me të tretët për shërbime të ndryshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.
6. Rekomandimet dhe dokumentet e tjera të përgatitura nga komisionet e posaçme/të specializuara të përhershme ose të përkohshme dhe nga të tretët bëhen efektive kur miratohen nga KKK, sipas rregullave të votimit të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 10 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI 6

PROCEDURAT PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E STANDARDEVE KOMBËTARE TË KONTABILITETIT

Neni 15

Standardet kombëtare të kontabilitetit

1. SKK do të përgatiten në bazë të SNRF. Në raste të justifikuara ato mund të përmbajnë përjashtime nga SNRF, zbatime të thjeshtuara ose shmangie nga SNRF për të gjitha ose një pjesë të njësisë ekonomike. Në rast përjashtimesh, SKK korresponduese përshkruajnë dhe paraqesin arsyet pse janë të nevojshme.
2. SKK u referohen SNRF përkatëse në bazë të të cilave ato janë përgatitur.

Neni 16

Procedurat për miratimin e SKK

1. Procedurat për miratimin e një SKK të ri ose të rishikuar përmban hapat e mëposhtëm:
 - a) miratimin e objektit-përmbajtjes së SKK të ri ose të rishikuar;
 - b) marrjen e vendimit për komisionin ose të tretët;
 - c) miratimi i autorit/hartuesit të zgjedhur
 - d) caktimi i afatit kohor për hartimin e SKK;
- e) projekt SKK (paragrafi 4 i nenit 10) miratohet kur votohet nga të paktën gjashtë anëtarë të KKK;
- f) publikimi i projekt SKK në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe dërgimi i tij për komente palëve kryesore të përfshira në këtë proces (përfshirë shoqatat profesionale, Bankën e Shqipërisë, organet tatimore etj.); afati për komentet është të paktën dy muaj nga data e publikimit të projekt SKK;
- g) marrja në shqyrtim e të gjitha komenteve dhe rishikimi i SKK, nëse është e nevojshme;
- h) miratimi i SKK përfundimtar;
- i) shpallja e SKK për zbatim nga Ministri Financave;
- j) publikimi i SKK në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në Fletoren Zyrtare.
2. Sa herë që IASB nxjerr një SNRF ose SNK të ri ose të rishikuar, KKK vlerëson nevojën për nxjerrjen e një SKK të ri ose ndryshimin e një SKK ekzistues.

KAPITULLI 7

ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Neni 17

Mbështetja administrative dhe teknike

1. Veprimtaritë e KKK-së mbështeten nga një personel i nevojshëm administrativ e teknik, i cili emërohet nga kryetari i KKK-së. Kryetari përcakton edhe detyrat që duhet të përmbushë ky personel.

2. Zyrat, struktura, organika dhe pagat e personelit administrativ dhe teknik propozohen nga kryetari i KKK-së, në bazë të nevojave aktuale dhe programit të punës së KKK-së, dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Ministria e Financave krijon kushtet e punës për KKK-në, duke siguruar zyrat e punës dhe pajisjet e nevojshme.

Neni 18

Burimi i financimit

1. Veprimtaritë e SKK financohen nga Buxheti i Shtetit. KKK ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e të ardhurave të krijuara nga veprimtaritë e KKK-së.

2. KKK mund të përdorë burimet e financimit dhe dhurimet nga njësi dhe shoqata të ndryshme financuese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI 8

DISPOZITAT E ZBATIMIT

Neni 19

Dispozita të fundit

1. Dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 germat (a)-(d) nuk zbatohen për SKK të hartuar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit

VENDIM

Nr.673, datë 26.10.2005

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIN NR.244, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT DHE TË SKEMËS SË FURNIZIMIT ME KARBURANT PA AKCIZË, PËR PËRCAKTIMIN E SASIVË TË KARBURANTIT, QË DO TË PËRDOREN PËR MEKANIKËN BUJQËSORE NË TRI ZONA TË VENDIT DHE SERRAT ME NGROHJE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.244, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot dhe të skemës së furnizimit me karburant, pa akcizë, për përcaktimin e sasive të karburantit që do të përdoren për mekanikën bujqësore në tri zona të vendit dhe për serrat me ngrohje”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për hartimin dhe propozimin e projektvendimit përkatës, për rregullimin ligjor të problemit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njësive postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim, 2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI DOGANOR	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim, 2005)	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1500
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 10.11.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"

Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë